

Trumpi uron
Kosovën për 18-vjetorin
e shtetësisë | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-SË DHE ZPS-JA THONË FJALËT PËRFUNDIMTARE,
TË MËRKURËN FLASIN THAÇI, VESELI, SELIMI DHE KRASNIQI

NESËR RADHA E STRATEGËVE TË LIRISË

- Mbrojtja e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit çmontuan pretendimet e ZPS-së



Prokuroria e Hagës dhe ekipet mbrojtëse kanë përfunduar deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Pas përfundimit të këtyre deklaratave, trupi gjyqësor ka parashtruar disa pyetje për ZPS-në dhe avokatët e Thaçit, Veselit dhe Selimit. Gjatë përgjigjeve, avokatët mbrojtës kanë hedhur poshtë pretendimet e ZPS-së për liderët e

UÇK-së. Ata kanë thënë se ZPS-ja nuk ka arritur të argumentojë asnjë nga pretendimet e saj. Avokati i Thaçit, Luka Misiqi, ka thënë se nuk është detyrë e trupit gjyqësor apo mbrojtjes t'i mbushë boshllëqet e provave të ZPS-së. Ndërsa nesër (e mërkurë) katërsjha e UÇK-së do ta thotë fjalën përfundimtare në këtë proces maratonik gjyqësor

AKTUALE



KALLASI: ZGJERIMI I BE-SË, ANTIDOT NDAJ IMPERIALIZMIT RUS
F. 2

PA DIALOG, PA BE? SFIDA E MANDATIT KURTI 3 F. 6

ME INICIATIVËN E VEPRIMTARIT SALI BISLIMI, 30 DEPUTETË ZVICERANË I DREJTOHEN GJYKATËS SPECIALE F. 5

EKONOMI



PROJEKTILIGJI PËR BUXHETIN MIRATOHET NË LEXIM TË PARË F. 8

BQK-JA DHE BANKA E SHQIPËRISË HAPIN EKSPOZITËN 'PARAJA RRËFEN: 100 VJET JETË DHE NGJARJE' F. 8

SPORT



ARMAND DUKA RIZGJEDHET PRESIDENT I FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT F. 11

OSMANI DHE RAMA THEKSOJNË RËNDËSINË E KOORDINIMIT TË VAZHDUESHËM KOSOVË - SHQIPËRI

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri
+38344685122

INFINITY
Digital Agency
Internet Website,
Marketing...

KALLASI: ZGJERIMI I BE-SË, ANTIDOT NDAJ IMPERIALIZMIT RUS

BRUKSEL, 16 SHKURT - Përfaqësuesja e lartë e Bashkimi Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, vlerësoi se Rusia nuk është më superfuqi, pasi ka arritur me vështirësi përparim në vijat e frontit krahasuar me vitin 2014. Ajo tha se zgjerimi i BE-së është antidot ndaj “imperializmit rus”. “Sot Rusia është e dobësuar, ekonomia e saj është në gjendje të rëndë, është e ndarë nga tregu energjetik evropian, dhe qytetarët po largohen. Kërcënimi më i madh është se mund të përfitojë më shumë në tryezën e negociatave sesa në fushëbetejë”, tha Kallas. Ajo paralajmëroi se “kushtet maksimaliste të Rusisë nuk mund të përmbushen me një përgjigje minimale”. Ajo paraqiti parimet e BE-së për arritjen e paqes në Ukrainë: nëse kufizohet ushtria ukrainase, duhet të kufizohet edhe ajo ruse. Rusia duhet t’i paguajë dëmet e luftës. Nuk ka amnisti për krimet e luftës dhe duhet të mundësohet kthimi i fëmijëve ukrainas të rrëmbyer. “Ky është

minimumi nëse paqja është vërtet qëllimi i Rusisë. Duke qenë se dyshojmë se nuk është, Evropa po armatoset së bashku me partnerët”, tha ajo. Kallasi paralajmëroi se okupimi i Donbas nuk është qëllimi përfundimtar i Rusisë. Ajo theksoi se Moska synon t’i dobësojë ekonominë përmes sulmeve kibernetike, pengimit të satelitët, sabotimit të kabllove nënujore, shkatërrimit të aleancave me dezinformata, duke përdorur sektorin e energjisë si mjet presioni dhe duke kërcënuar me armë bërthamore. Shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas, tha se blloku evropian duhet ta sigurojë stabilitetin në fqinjësinë e saj, në lindje dhe jug, duke shtuar se zgjerimi është “antidot ndaj imperializmit rus”. Sipas saj, zgjerimi është një zgjedhje gjeopolitike që BE-ja duhet ta mbështesë. Kallasi theksoi se Bashkimi Evropian mbetet një forum tërheqës dhe se “lista e pritjes” për anëtarësim po zgjerohet. “Qytetarët ende duan të bashkohen me bllokun tonë,



dhe jo vetëm evropianët. Kur vitin e kaluar isha në Kanada, më thanë se më shumë se 40 për qind e kanadezëve kanë interesim për t’u bashkuar me BE-në. Shpresoj vetëm që ata që presin prej kohësh të mos duhet të presin edhe më gjatë”, tha Kallasi gjatë një fjalimi në Konferencën e Sigurisë së Munihut, duke refuzuar pretendimet se Evropa po përballet me zhdukje civilizimi. E pyetur rreth mundësisë së pranimit të shpejtë të Ukrainës në BE, dhe çfarë diskutohet në qarqet e Brukselit, ajo pranoi se ende nuk ka një përgjigje të

qartë pozitive për këtë çështje. Ideja për anëtarësim të përshpejtuar nënkupton hyrjen e Ukrainës në bllokun evropian më herët, me disa kufizime, përfshirë të drejtat e votës, ndërsa anëtarësimi i plotë do të kërkonte përmbushjen e të gjitha standardeve dhe një vendim unanim të shteteve anëtare. Kaja Kallas konsideron se kjo nuk do t’i shkurajonte vendet që presin prej kohësh, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. “Edhe ne [në Estoni] duhet të realizojmë reforma të shumta për t’u bashkuar me BE, por situata

gjeopolitike ishte vendimtare. Ndoshta nuk është realiste të thuash që të gjithë duhet të hyjnë njëkohësisht, sepse ka vende të vogla si Mali i Zi dhe Shqipëria që presin prej kohësh dhe punojnë aktivisht në reforma. Nëse duam ndryshime, duhet të marrim vendime më shpejt. Nuk mund të jetë që kandidatët t’i kryejnë detyrat e tyre, e ne më pas t’u themi se nuk jemi gati t’i pranojmë”, tha Kallasi në Munih. Konferenca e Sigurisë së Munihut përfundon më 15 shkurt pas një sesiioni treditor. Ky është një nga takimet më të rëndësishme gjeopolitike në botë, që mbledhi udhëheqës dhe zyrtarë të lartë. Organizatorët thanë se edicioni i këtij viti ishte më i madhi deri tani, me më shumë se 1 000 delegatë, përfshirë rreth 50 kryeministra dhe ministra të Jashtëm. Konferenca u zhvillua në një moment të tensioneve globale, përfshirë luftën në Ukrainë, tensionet rreth Iranit dhe diskutimet mbi të ardhmen e NATO-s dhe aleancës transatlantike.

IRANI SHPREH GATISHMËRI PËR MARRËVESHJE BËRTHAMORE NËSE SHBA-ja HEQ SANKSIONET

TEHERAN, 16 SHKURT - Irani ka hapur mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për programin e tij bërthamor me Shtetet e Bashkuara nëse Uashingtoni heq sanksionet që ka vendosur ndaj regjimit iranian. Në një intervistë për BBC-në dhënë në Teheran, zëvendësministri i Jashtëm iranian, Majid Takht-Ravanchi, tha: “Ne jemi të gatshëm të bisedojmë për këtë dhe çështje të tjera që lidhen me programin tonë [bërthamor] me kusht që ata të jenë të gatshëm të nisin të flasin për sanksionet”. “Këto sanksione duhet të jenë, po ashtu, në tavolinë të bisedimeve”, tha ai, duke shtuar se topi tani “është në anën amerikane për të dëshmuar se ata duan një marrëveshje”. Takht-Ravanchi nuk specifikoi nëse po fliste për disa sanksione apo të gjitha sanksionet e vendosura nga ShBA-ja, që shënjestrojnë bankat dhe eksportet e naftës, si dhe sektorë të tjerë. Këto masa janë vendosur në vitet e fundit. Këto deklarata vijnë para

raundit të ri të bisedimeve ShBA - Iran që do të mbahet në Gjenevë më 17 shkurt. Delegacioni amerikan do të përfshijë të dërguarit Steve Witkoff dhe Jared Kushner dhe përfaqësuesit e Omanit do të veprojnë si ndërmjetës. Omani ishte mikpritës i bisedimeve indirekte mes Teheranit dhe Uashingtonit që u zhvilluan më herët gjatë shkurtit. Sipas BBC-së, Takht-Ravanchi përmendi ofertën e Iranit për ta holluar uraniumin e tij të pasuruar deri në 60 për qind si sinjal të vullnetit për kompromis dhe tha se pasurimi në nivel zero - diçka që kërkon ShBA-ja - “nuk është më në tavolinë të bisedimeve”. Shtetet perëndimore që një kohë të gjatë dyshojnë se Irani po synon të krijojë një armë bërthamore, por Teherani insiston se programi i tij është vetëm për qëllime civile. Fuqitë botërore arritën një marrëveshje bërthamore me Teheranin në vitin 2015, që synonte parandalimin e një arme bërthamore nga Irani. Atëbotë, Perëndimi lehtësoi sanksionet ekonomike ndaj

Teheranit, por Republika Islamike nisi të tërhiqej nga zotimet e marrëveshjes, pasi Donald Trump gjatë mandatit të parë si president i ShBA-së u tërhoq nga kjo marrëveshje më 2018 dhe rivendosi sanksionet. Donald Trump i ka cilësuar bisedimet fillestare midis ShBA-së dhe Iranit si “pozitive”, por gjatë fundjavës tha se ndryshimi i regjimit është “gjëja më e mirë që mund të ndodhë” në Iran. Ai konfirmoi po se një aeroplanmbajtës i dytë amerikane, USS Gerald R. Ford, së shpejti do t’i bashkohet një flote “masive” të ShBA-së në Detin Arabik. Presidenti amerikan ka kërcënuar vazhdimisht me sulme ndaj Iranit nëse nuk arrihet një marrëveshje që kufizon programin e tij bërthamor. Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli shënjestrojnë objektet bërthamore dhe ushtarake të Iranit gjatë një fushate 12-ditore bombardimesh në qershor të vitit të kaluar. Në një panel diskutimi në Konferencën e Sigurisë së Munihut, më 13 shkurt, Rafael



Grossi, kreu i Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore (IAEA), tha se peizazhi bërthamor i Iranit ka ndryshuar rrënjësisht pas sulmeve amerikane, duke shtuar se “infrastruktura fizike e programit bërthamor të Iranit është dëmtuar gjerësisht dhe se monitorimi i ardhshëm duhet të përqendrohet jo vetëm në atë që ka mbetur, por edhe në mënyrën se si kapacitetet bërthamore të Teheranit mund të zhvillohen

në të ardhmen”. Inspektorët e IAEA-s janë kthyer në Iran, por ende nuk kanë qasje në objektet që u goditën gjatë bombardimeve. Bisedimet e ardhshme vijnë, po ashtu, disa javë pas shtypjes së dhunshme të protestave antiqeveritare në mbarë Iranin. Forcat iraniane të sigurisë kanë vrarë mijëra protestues dhe kanë arrestuar më shumë se 53 000 persona, sipas grupeve për të drejtat e njeriut.

OSMANI DHE RAMA THEKSOJNË RËNDËSINË E KOORDINIMIT TË VAZHDUESHËM KOSOVË - SHQIPËRI

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka diskutuar për marrëdhëniet ndërshtetërore dhe për zhvillimet rajonale.

Në fokus të takimit ishin, para së gjithash, koordinimi i ngushtë politik dhe institucional, si dhe përkushtimi i ndërsjellë për shtimin e bashkëpunimit në politikën e jashtme në funksion të avancimit të interesave të përbashkëta strategjike.

Të dy liderët theksuan rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm

Kosovë - Shqipëri si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon, si dhe rolin konstruktiv të të dyja shteteve në nisma ndërkombëtare që promovojnë paqen dhe bashkëpunimin. Gjatë takimit u diskutua edhe për bashkëpunimin në kuadër të Bordit të Paqes, duke u theksuar rëndësia e angazhimit të përbashkët në iniciativa globale që promovojnë dialogun, sigurinë dhe vlerat demokratike. Në këtë kontekst u nënvizua se Kosova dhe Shqipëria janë të nderuara me ftesën nga presidenti Donald Trump në Bordin e Paqes si dëshmi e respektit dhe partneritetit me aleatët strategjikë.

Presidentja Osmani dhe



kryeministri Rama riafirmuan vullnetin e tyre për thellimin e bashkëpunimit vëllazëror ndërmjet dy shteteve, duke vënë theksin në partneritetin

ekonomik, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe krijimin e mundësive konkrete që ndikojnë drejtpërdrejt në afrimin dhe mirëqenien e

qytetarëve të të dy vendeve.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani përgëzoi kryeministrin Rama për përparimin në rrugën drejt Bashkimi Evropian, duke e cilësuar dëshmi e angazhimit të qartë evropian të Shqipërisë dhe si një zhvillim që forcon perspektivën evropiane të gjithë rajonit.

Në përmbyllje të takimit, kryeministri Rama e uroi presidenten Osmani dhe popullin e Kosovës për 18-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, duke rikonfirmuar mbështetjen e plotë dhe të palëkundur të Republikës së Shqipërisë për shtetin e Kosovës dhe të ardhmen euroatlantike.

PROMOVOHET NË PRISHTINË LIBRI PËR KATËRSHEN E UÇK-së ‘KUR HESHTJA FLET’ I AUTORIT AHMET SHALA

PRISHTINË, 16 SHKURT (ER) - “Kur heshtja flet” është libri i prof. dr. Ahmet Shalës, akademik e ish-ambasador i Kosovës, i cili mblodhi të hënën në Prishtinë figura të rëndësishme, e përmes të cilit libër me qartësi e thellësi përshkruan gjykimin në Hagë kundër ish-drejtesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Fjalën e nis me falënderimin e veçantë për kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama, i cili ishte i pranishëm, nga ku i dha kuptim edhe besimit të tij në Zotin të cilin thotë se kur ishte fëmijë nuk e dinte kush është. E pranishme ishte edhe presidentja Vjosa Omani, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, bashkëshortja e Thaçit, Veselit dhe Krasniqit, kryetarë komunash, deputetë e ish-luftëtarë të UÇK-së.

Shala ka thënë se librin e shkroi si një qytetar i thjesht në lirinë që e sollën, duke iu referuar Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit. “Ky libër nuk lindi për të qenë thjesht një botim. Lindi krejt rastësisht, mbase si një nevojë e shpirtit tim, një ndjenjë e thellë, e ndrydhur. Me shpirt të zemrës dhe një zë që shpërtheu fare spontanisht, për të folur dhe për të vepruar. Kur fillova të shkruaj, nuk shkrova si akademik, diplomat apo studiues, por shkrova si një njeri i thjeshtë i këtij vendi, tanimë i lirë nga ata burra. Shkrova si një qytetar, si një shqiptar, si dikush që ka parë, dëgjuar, ka prekur dhe përjetuar vetë, por edhe ka parë në sytë e të tjerëve dhimbjen që

nuk shuhet, drejtësinë e vonuar dhe dinjitetin që nuk dorëzohet kurrë. Përmes këtij libri flasin ata që prehen në parajsë, heronjtë tanë; flasin ata që janë aty ku nuk do të mund të ishin; flasin ata që heshtja i ka rënduar më shumë se çdo fjalë. Heshtja jonë, pra. Këtë libër fillova ta shkruaj pas takimit një më një me katër udhëheqësit tanë në Hagë: Hashim Thaçi, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. I pashë me sy politikë, as diplomatikë e as studiues, por me syrin e njeriut të thjeshtë. I pashë jo si personalitete me funksione që kanë mbajtur, por si njerëz të zakonshëm, si bijë, baballarë, bashkëluftëtarë, të atyre që prehen në Likoshan, Qirez, Glllogjan, Studime, Mej, Krushë, Izbicë e gjithandej në tokën e atdheut tonë. Kuptova diçka thelbësore: kuptova që historia e Kosovës nuk ndahet në kapituj sikurse në historitë e botuara”, ka thënë autori i librit, Ahmet Shala.

Rama thotë se akuzat ndaj ish-krerëve të UÇK-së janë pengmarrje poli-tike, jo drejtësi

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, mori pjesë në promovimin e librit “Kur heshtja flet” nga Ahmet Shala, akademik dhe ish-ambasador i Kosovës, që trajton gjykimin në Hagë kundër udhëheqjes së UÇK-së. në foltore ai kritikoi vendimet e drejtësisë në Hagë, duke theksuar se ato po dëmtojnë Kosovën dhe luftën



çlirimtare të UÇK-së.

Rama shprehu kritika edhe ndaj Prokurorisë së Hagës që po përpiqet të lidhë katër ish-krerët e UÇK-së me akuzat pa prova me gjenocidin që kreu ish-Jugosllavia.

Kryeministri shqiptar tha se katër ish-krerët e UÇK-së u armatosën kundër një pushtimi shfarosës dhe nuk u armatosën për të imponuar. “Ata u armatosën kundër një pushtimi shfarosës dhe nuk u armatosën për ta imponuar sundimin e tyre në një territor të huaj, por për ta mbrojtur sundimin e tyre në tokën e tyre. Ata vetë me dorën e tyre e votuan në Kuvendin e Kosovës, një gjykatë e cila në letër është një gjykatë e Kosovës, por nuk është gjykatë për të vendosur mbi të akuzuarit e Kosovës. Gjithçka nisi nga një raport i Dick Martyt dhe u shty përpara nga përfaqësuesit e Vladimir Putin në Këshillin e Evropës”, deklaroi Rama.

Gjithë këtë Rama e quajti katastrofë për drejtësinë ndërkombëtare. Ai tha se Gjykata Speciale është më politike sesa gjykata e Serbisë

në raport me Kosovën.

“Kjo gjykatë është edhe më politike sesa gjykata e Serbisë në raport me Kosovën. Drejtësia ndërkombëtare, e financuar nga shtete demokratike, vazhdon, për turp, ta ndjekë me diferencë më të madhe këtë katastrofë; faktikisht bën që ne sot të marrim një pikëpyetje për veten tonë, se çfarë mund të bëjmë dhe duhet të bëjmë”, ka pohuar Rama, duke shtuar kjo është pengmarrje për arsye politike, jo të Perëndimit, siç është thënë, por të atyre forcave që kanë dashur të barazojnë dy gjëra që nuk barazohen dot: dhunën etnike të një makinerie lufte dhe luftën çlirimtare të UÇK-së.

Osmani: Në Hagë po gjykohen padrejtësisht proceset tona jetike - liria dhe pavarësia

Në fjalimin e saj, presidentja Osmani theksoi rëndësinë historike të lirisë së Kosovës dhe sakrificën e brezave që udhëhoqën luftën çlirimtare. “Kosova pati bijë e bija që udhëhoqën luftën tonë çlirimtare dhe i dolën zot atdheut, duke dëshmuar se liria ishte më e shtrenjtë se jeta. Këtë histori, këtë të vërtetë dhe këtë triumf, duhet ta mbrojmë me krenari në çdo vend të botës, sepse UÇK-ja është ideali më i fuqishëm i ndërtuar nga shqiptarët ndër shekuj. Por për ta mbrojtur të vërtetën duhet edhe ta shkruajmë atë. Ky libër i autorit Ahmet Shala, ‘Kur heshtja flet’, flet jo vetëm për luftën tonë, por edhe për gjykimin e padrejtë që po bëhet ndaj proceseve tona jetike, ndaj lirisë dhe pavarësisë sonë dhe përpjekjeve për çlirim që u ndërmorën në shërbim të lirisë dhe mbijetesës së popullit tonë”, tha Osmani.





MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-SË DHE ZPS-JA THONË FJALËT PËRFUNDIMTARE, TË MËRKURËN FLASIN THAÇI, VESELI, SELIMI DHE KRASNIQI

NESËR RADHA E STRATEGËVE TË LIRISË

- Mbrojtja e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit çmontuan pretendimet e ZPS-së

Prokuroria e Hagës dhe ekipet mbrojtëse kanë përfunduar deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Pas përfundimit të këtyre deklaratave, trupi gjykues ka parashtruar disa pyetje për ZPS-në dhe avokatët e Thaçit, Veselit dhe Selimit. Gjatë përgjigjeve, avokatët mbrojtës kanë hedhur poshtë pretendimet e ZPS-së për liderët e UÇK-së. Ata kanë thënë se ZPS-ja nuk ka arritur të argumentojë asnjë nga pretendimet e saj. Avokati i Thaçit, Luka Miseti, ka thënë se nuk është detyrë e trupit gjykues apo mbrojtjes t'i mbushë boshllëqet e provave të ZPS-së. Ndërsa nesër (e mërkurë) katërshtja e UÇK-së do ta thotë fjalën përfundimtare në këtë proces maratonik gjyqësor

EPOKA E RE**Lirim GECI**

HAGË, 16 SHKURT - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe avokatët e liderëve të UÇK-së kanë shpalosur deklaratat përfundimtare në procesin gjyqësor në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi. Të parët që kanë filluar paraqitjen e deklaratave përmbyllëse kanë qenë prokurorët e ZPS-së të cilët kanë kërkuar dënimin e katërshtes së UÇK-së me nga 45 vjet burgim. Pas ZPS-së fjalën e kanë pasur avokatët e liderëve të UÇK-së, të cilët kanë

çmontuar aktakuzën e ZPS-së. Ata kanë kërkuar nga trupi gjykues që Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi të shpallen të pafajshëm, pasi ZPS-ja në asnjë rast nuk ka arritur t'i argumentojë pretendimet e saj. Për disa ditë ekipet mbrojtëse të katërshtes së UÇK-së kanë argumentuar se klientët e tyre nuk kanë kryer asnjë krim siç ka pretenduar ZPS-ja. Po ashtu, ata kanë argumentuar se ZPS-ja është mbështetur në prova të dorës së dytë. Pas përfundimit të deklaratave, trupi gjykues u ka parashtruar pyetje prokurorëve dhe ekipeve mbrojtëse të liderëve të UÇK-së.

Të premtën prokurorët e ZPS-së janë vënë në siklet teksa gjykatësit kanë parashtruar pyetjet e tyre në përmbyllje të deklaratave. Gjykatësi Fergal Gejnor ka pyetur ZPS-në nëse do të duhej t'u gjendej ndonjë avokat të ndaluarve nga UÇK-ja në rrethana lufte. ZPS-ja ka insistuar se nuk mund të ndalosh persona pa procedura të rregullta ligjore. Por, kjo deklaratë është kundërshtuar nga mbrojtja e liderëve të UÇK-së. Ndërsa avokati i Veselit, Rodney Dixon, ka këmbëngulur në pyetjen e gjykatësit nëse UÇK-ja kishte baza ligjore për të

paraburgosur ushtarë të ushtrisë së atëhershme serbe gjatë luftës në Kosovë. "E drejta ndërkombëtare humanitare për konflikte ushtarake parashikon se mund të arrestohen persona që cilëson si rrezik për sigurinë. Kemi cituar edhe shtete të mëparshme që e kanë bërë këtë", ka thënë Dixon. Gjykatësi e ka ndërprerë Dixonin, duke e pyetur nëse UÇK-ja si aktore joshitetore e gëzonte një të drejtë të tillë. Dixon është përgjigjur duke thënë se: "Po. Jurisprudenca e ka dëshmuar një gjë të tillë, mund të zbarohet për të dyja, edhe për shtetin edhe për entitetin i cili është pjesë e një konflikti të brendshëm të armatosur". Ndërsa mbrojtja e Thaçit ka marrë shembull rastin e një rezervisti në ushtrinë serbe, duke thënë se ka pasur arsye për të besuar se ky individ ishte perceptuar si luftëtar nga personat që e kanë bërë arrestimin e tij. Gjyqtari ka kërkuar që ta dijë se këta persona të ndaluar çfarë statusi kanë pasur sipas së

drejtës humanitare ndërkombëtare në momentin e arrestimit të tyre. Në përgjigjen e tij, avokati i Thaçit, Luka Miseti, ka marrë shembull tetë ushtarët e armatës jugosllave, duke thënë se ata përbëjnë rastin më të qartë të personave të armatosur dhe që ishin luftëtarë. Kurse sa i përket çështjes së të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe konfliktit të armatosur jondërkombëtar, Miseti ka thënë se që në fillim të çështjes, ZPS-ja ka rënë dakord që UÇK-ja ka pasur të drejtën e parandalimit me kushtin që të mos kishte abuzime. Por, në masën kur ekzistonte dyshimi i bazuar se këta persona kishin marrë pjesë në veprime ushtarake, sipas Miseti, ata janë luftëtarë. Në anën tjetër, gjyqtari Guenael Metraux ka kërkuar sqarim nga ZPS-ja mbi kërkesën e tyre për t'i dënuar liderët e UÇK-së. "Në aktakuzë ju i kërkon trupit gjykues të shpallë fajësinë në lidhje me secilën nga 10 akuzat që ngrihen, por nuk i kërkon

ME INICIATIVËN E VEPRIMTARIT SALI BISLIMI, 30 DEPUTETË ZVICERANË I DREJTOHEN GJYKATËS SPECIALE

PRISHTINË, 16 SHKURT - Pas rezolutave të miratuara në Kuvendin e Shqipërisë dhe në Kuvendin e Kosovës ditët e fundit, angazhimi për një proces të drejtë po merr jehonë ndërkombëtare.

Me iniciativë të veprimitarit Sali Bislimi dhe në vazhden e komunikimeve ndërkombëtare,

një rezolutë e mbështetur nga 30 deputetë zviceranë u adresua sot në Dhomat e Specializuara në Hagë, së bashku me kryetarin e OVLUÇK-së, Hysni Gucati. OVLUÇK ka njoftuar se adresimi i këtij dokumenti përfaqëson një hap simbolik në drejtim të respektimit të

standardeve ndërkombëtare të drejtësisë dhe të parimit të një procesi të paanshëm. “OVLUÇK do ta vazhdojë angazhimin e saj në çdo nivel, kombëtar dhe ndërkombëtar, për mbrojtjen e vlerave të luftës sonë çlirimtare dhe për drejtësi të barabartë”, ka njoftuar OVLUÇK-ja.



trupit gjykses të shpallë fajësinë për incidentet individuale që janë relevante për akuzën. Keni më shumë se 40 vrasje të pretenduara, shpalljen e fajësisë që kërkoni ju është vetëm për pikën 8, 9 dhe 10, a e kam kuptuar drejtë?”, ka pyetur gjykatësi Metraux.

Ndërsa kryeprokurorja Kimberley West ka thënë se pikat lidhen me këto krime siç pretendon ZPS-ja, por që janë të bazuara në incidentet individuale.

Pas deklaratave të ZPS-së dhe avokatëve, nesër (e mërkurë) liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, t'i paraqesin qëndrimet e tyre në këtë proces gjyqësor, i cili ka nisur në prill të vitit 2023.

Avokati Misiq, ZPS-së dhe trupit gjykses: Thaçi është i pafajshëm. Dënimi do të ishte padrejtësi historike. S'mund ta rishkruani historinë e Kosovës

Mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi ka shkëlqyer të mërkurën e 11 shkurtit, duke shkërmoqur pretendimet e ZPS-së. Avokati Luka Misiq ka deklaruar se Thaçi është i pafajshëm dhe kjo është pikënisja prej ku duhet të merret vendimi nga trupi gjykses. Ai ka kërkuar lirinë e Thaçit dhe kthimin e tij në Kosovë. “Kur t'i filloni kuvendimet tuaja, ju do të filloni nga qëndrimi se Hashim Thaçi është i pafajshëm dhe më pas ju do të vlerësoni nëse provat e paraqitura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ju kanë bindur juve, jashtë dyshimit të arsyeshëm, se Hashim Thaçi është fajtor”, u ka thënë Misiq gjyqtarëve.

Po ashtu, ai u ka thënë gjyqtarëve se shpallja fajtor e Thaçit do të përbente padrejtësi ligjore dhe historike. “Argumentet e ZPS-së nuk përbëjnë interpretimin e arsyeshëm vetëm të provave, që është standardi që duhet arritur që ju ta rishkruani historinë e

Kosovës, në këtë rast për ta shpallur fajtor Hashim Thaçin. Ka dyshime të bazuara të mjaftueshme për ju që ta shpallni atë jofajtor për të gjitha pikat e aktakuzës”, ka thënë Misiq.

Në këtë kontekst, Misiqi ka përmendur disa nga deklaratat e dëshmitarëve në mbrojtje të Thaçit. Në mesin e figurave që kanë dëshmuar në mbrojtje të Thaçit janë: ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s, Wesley Clark, ish-ndihmësi i sekretarit amerikan i Shtetit, James Rubin dhe diplomati i pensionuar amerikan, Christopher Hill.

Avokati i Thaçit i ka thënë trupit gjykses se e sheh problematik faktin që në gjithë dosjen e ZPS-së janë shpërfillur të gjitha provat të cilat diskreditojnë provat dhe pretendimet e saj. Duke folur për hierarkinë e UÇK-së, Misiqi ka deklaruar se Prokuroria e Hagës është frikësuar ta pyeste Bislim Zyrarin lidhur me rolin e Thaçit në operacionet ushtarake. “ZPS-ja nuk guxonte t'ia bënte pyetjet sepse kishte frikë për përgjigjet që do të merrte. Nuk është e drejtë për dëshmitarin e as të akuzuarit”, ka thënë Misiqi.

Avokati i Thaçit gjatë paraqitjes së deklaratës përmbyllëse është fokusuar edhe te pika e akuzës së ZPS-së se ka ekzistuar një “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale (NPK)”, në krye me të akuzuarit, me qëllim të marrjes nën kontroll të gjithë Kosovës. Misiqi u ka thënë gjyqtarëve se nuk ka pasur prova të

drejtpërdrejta që ka ekzistuar një plan i tillë. Misiqi ka thënë se nuk është i vërtetë as pretendimi i prokurorisë se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, në verën e vitit 1998, ka refuzuar në çdo mënyrë të mundshme, “me zjarr” qeverinë e zgjedhur të LDK-së dhe që ndërmori hapa për të krijuar “një qeveri të re”. Në sallën e gjyqit në Hagë, avokati i Thaçit, Luka Misiqi, ka kundërshtuar pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) lidhur me komunikatat e UÇK-së. Ai ka thënë se nuk ekzistojnë prova që Thaçi ka ushtruar funksionin e drejtorit të Drejtorisë Politike para periudhës së përmendur në aktakuzë.

Më tutje, avokati i Thaçit ka thënë se prokuroria nuk ka sjellë prova që ai ka qenë figurë udhëheqëse në Lëvizjen Popullore të Kosovës, duke e cilësuar këtë si pretendim të pabazuar. Gjithashtu, ai ka theksuar se nuk ka dëshmi që Thaçi ka hartuar komunikata politike të UÇK-së.

Mbrojtja: ZPS-ja me prova të pavërtetuara kundër Veselit

Avokati kryesor i Veselit, Rodney Dixon, më 12 shkurt ka thënë se çështja kundër klientit të tij është “si përpjekje për ta gjetur njëbrireshin”. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë inkriminuese kundër Veselit. Sipas tij, rasti ndaj Veselit është

unik “sepse nuk ka asnjë provë e jo më të këtë bërë ndonjë vepër penale”.

Dixon ka thënë se rasti ndaj liderëve të UÇK-së ka zgjatur për më shumë se pesë vjet, por është shprehur i bindur se Veseli do të lirohet i pafajshëm. “Veseli meriton një vendim të drejtë dhe të duhur. Ai duhet të lirohet dhe të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat. Nëse ndodh e kundërta, do të ishte një padrejtësi e madhe”, ka thënë Dixon.

Duke kritikuar ZPS-në, avokati Dixon ka thënë se janë dy raste kur prokuroria ka ofruar dëshmi kundër Veselit, por të cilat, sipas tij, janë dëshmi të pavërtetuara. Sipas tij, ZPS-ja synon të përdorë një provë, të pavërtetuar, të një personi që nuk është paraqitur në gjykatë, dhe ta përdorë si bazë për fajësinë e Veselit, duke shtuar se këto nuk janë në formën e deklaratës të një dëshmitari. Pretendimi i dytë, ka thënë Dixon, ka të bëjë për një të ndaluar në Kleçkë. Ai ka thënë se edhe ky pretendim i ZPS-së është e bazuar në një informacion të dorës së dytë. Avokati Dixon i ka thënë trupit gjykses se shumë dëshmitarë të ZPS-së kanë dhënë dëshmi të rreme dhe atë nën betim. Në këtë drejtim, Dixon i ka bërë thirrje trupit gjykses që ta ndajë faktin nga shpikjet. Mbrojtësi i Veselit ka insistuar se ndaj klientit të tij nuk ka asnjë provë për përfshirje në krime, por ka thënë se “kemi ngelur në duart e thashethemeve”.

Dixon ka thënë se Veseli ka luftuar për çlirimin e Kosovës nga regjimi i Serbisë. “Ai luftoi për lirinë e Kosovës dhe për të pasur një të ardhme pa ndarje dhe pa brutalitet. Por, ky nuk është krim”, ka thënë Dixon. Sipas tij, ZPS nuk ka asnjë provë kundër Veselit dhe asnjë dëshmitar nuk e ka përmendur atë, madje nuk e kanë njohur Veselin.

Rodney Dixon ka hedhur poshtë pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për funksionimin e Shërbimit Informativ të Kosovës (ShIK) në kohën e luftës dhe drejtimin e tij nga Veseli. Dixon ka thënë se provat tregojnë se gjatë luftës ishte e pamundur të krijohej një strukturë e tillë. Avokati i Veselit ka kërkuar nga Gjykata Speciale të ketë kujdes nga dëshmitë e dhëna nga Serbia.

Mbrojtja: Rexhep Selimi është tërësisht i pafajshëm. ZPS-ja s'ka arritur t'i provojë akuzat

Pas mbrojtjes së Kadri Veselit, deklaratën përfundimtare në procesin gjyqësor më 12 dhe 13 shkurt e ka paraqitur ekipi mbrojtës i Rexhep Selimit. Avokati kryesor i Selimit, Geoffrey Roberts, ka thënë se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë asnjë nga krimet që i ngarkohen klientit të tij. “Selimi është tërësisht i pafajshëm për të gjitha krimet në aktakuzë. ZPS-ja thjesht nuk ka arritur të provojë asnjë prej këtyre krimeve të pretenduara. Kaq është dhe ky është qëndrimi ynë”, ka thënë ai.

Roberts ka thënë se qëndrimi i mbrojtjes është se nuk ka ekzistuar “Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale (NPK)”. Sipas tij, pretendimi i ZPS-së për një ndërmarrje të tillë “është i mangët në logjikë dhe i mangët në prova dhe kjo shihet në çdo aspekt”, ka thënë Roberts.

Avokati i Selimit ka thënë se pretendimi kryesor i prokurorisë është se të akuzuarit së bashku me anëtarët e tjerë të asaj që e cilëson si “ndërmarrje e përbashkët kriminale” kishin për qëllim marrjen nën kontroll



të Kosovës dhe largimin e kundërshtarëve. Roberts si ka thënë se qëllimi i UÇK-së ka qenë dhënia fund shtypjes nga regjimi i Slllobodan Millosheviqit.

Roberts si ka përmendur një rast nga dosja e prokurorisë, ku Selimi kishte kërkuar lirin e një të ndaluar, që ishte marrë në pyetje nga UÇK-ja, nën dyshimet se ishte bashkëpunëtor i Serbisë. Roberts, po ashtu, ka thënë se disa ndalime nga komandantët e zonave u kryen pa dijeninë e shtabit të përgjithshëm dhe ato u fshehën nga shtabi, duke argumentuar se “kjo mungesë logjike” e pretendimit të ZPS-së se komunikatat ishin udhëzime “është befasese”.

Po ashtu, avokati Roberts ka vënë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarëve të ZPS-së për disa incidente që e lidhin klientin e tij me krime të pretenduara, sikurse ndalimi dhe kërcënimi i personave të ndryshëm. Ai ka thënë se për një incident të prillit të vitit 1999 në Kleçkë, ZPS-ja është mbështetur në një dëshmitar, i cili ka “shpikur historinë” se ishte takuar me Selimin, prandaj ka arritur ta identifikonte më pas. Për një dëshmitar tjetër, Roberts si ka thënë se ka histori të rrëfimeve të pavërteta para ZPS-së, në bazë të interesave të tij. Ai ka mohuar se ka prova që Selimi

është përfshirë në incidentin e Qirezit, përkatësisht ndalimit të disa anëtarëve të UÇK-së e as në ndalimin e Blerim Kuçit. Po ashtu, Roberts si ka përmendur një incident në Likoc në gusht të 1998-s, ku ZPS-ja pretendon se Selimi ka marrë pjesë në marrjen në pyetje të një të ndaluar.

Avokati Roberts si ka thënë se ky dëshmitar e ka gënjyer trupin gjykues. “Kompensimi financiar që dëshmitari i ka pranuar ZPS-së, se ishte i interesuar, duket të ketë mjaftuar që ky dëshmitar ta gënjente sy për sy trupin gjykues”, ka thënë Roberts.

Mbrojtja e Krasniqit: Ai është i pafajshëm, ZPS-ja mbylli sytë para fakteve

Ekipi mbrojtës i zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, të premtën e javës së kaluar dhe këtë të hënë ka paraqitur deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë. Avokatja kryesore e Krasniqit, Venkateswari Alagendra, para trupit gjykues ka vlerësuar se klienti i tij është i pafajshëm. Ajo ka kërkuar nga trupi gjykues që Krasniqin ta shpallë të pafajshëm. “Parashtrojmë që është vetëm një opsion që të merrni vendim pafajësie ndaj të gjitha akuzave të ngritura ndaj Jakup Krasniqit. Në fund të



parashtrimit do t’ju bëjmë thirrje, të nderuar gjykatës, që ta shpallni të pafajshëm Krasniqin dhe ta lejoni këtë zotëri 75-vjeçar të kthehet në familjen e tij dhe të kalojë vitet që i ka caktuar Zoti me familjen e tij”, ka thënë Alagendra.

Alagendra ka akuzuar ZPS-në se ka përzgjedhur dokumente dhe pjesë të dëshmive të dëshmitarëve sipas interesave të saj, duke shtuar se ka injoruar pjesët e dëshmive që nuk i përshtaten prokurorisë.

Në këtë drejtim, Alagendra ka thënë se ZPS-ja nuk ua ka dhënë peshën e duhur provave shfaqësuese duke përmendur shembullin e një urdhri të lëshuar nga shefi i shtabit të UÇK-së, Bislim Zyrapi, më 28 nëntor 1998, dhe ka përzgjedhur vetëm pjesë të dëshmisë së tij dhënë prokurorisë më 2019. Ajo ka thënë se ZPS-ja është mbështetur në “spekulime dhe pretendime të pambështetura” në akuzat ndaj Krasniqit. Ajo ka thënë se nuk ka asnjë dëshmitar që thotë se Krasniqi e ka keqtrajtuar.

Alagendra ka thënë se ZPS-ja nuk ka arritur ta vërtetojë lidhjen e pretenduar të klientit të saj me krimet. Po ashtu, ajo ka pretenduar se ZPS-ja nuk ka bërë punën siç duhet, pasi nuk ka ftuar dëshmitarë kyç që do

të ofronin informacione për kontekstin e luftës dhe të ofronin informacione për hierarkinë e UÇK-së. Ajo e ka cilësuar “të shtrembëruar dhe të paplotë” dokumentacionin e ofruar nga ZPS-ja, dhe ka thënë se trupi gjykues do të përballet me hetime selektive të kryera nga organi ndjekës. Mbrojtja e Jakup Krasniqit ka thënë se ZPS-ja nuk ka verifikuar autorësinë, autenticitetin apo

besueshmërinë e materialeve që janë sekuestruar në nëntor të vitit 2020 në shtëpinë e klientit të tij. Avokatja Alagendra ka thënë se dihet që Krasniqi ka botuar libra dhe prokuroria “nuk merr parasysh provat se Krasniqi po mbledhte materiale në lidhje me UÇK-në pas luftës për ta shkruar librin e tij dy dekada më parë”. Sipas saj, Krasniqi e dinte që ZPS-ja po hetonte në Kosovë shumë më herët sesa kur u ngrit aktakuza ndaj tij, dhe fakti që nuk i ka shkatërruar këto materiale që mund ta inkriminojë, duhet të shihet si pozitiv dhe pretendoi se është fakt që ai është i pafajshëm. Avokatja e Krasniqit ka thënë se materialet e marra nga Serbia kundërshtoheshin nga verifikimet në terren. Alagendra ka thënë se disa dëshmitarë kanë treguar për pasaktësinë e dokumenteve zyrtare serbe.

Avokati i Thaçit: S’është detyrë e trupit gjykues apo mbrojtjes t’i mbushë boshllëqet e provave të ZPS-së

Mbrojtja e Hashim Thaçit, e përfaqësuar nga avokati Luka Misetiq, duke u përgjigjur në pyetjet e gjyqtarit Guenawl Mettraux lidhur me qëndrimet kontradiktore në mes tyre dhe prokurorisë rreth dëshmisë së Bislim Zyrapit, ka thënë se as ata dhe as trupit gjykues nuk e kanë për detyrë t’i mbushin boshllëqet në provat e ZPS-së. “Së pari duhet theksuar se barra e provës është vetëm dhe vetëm e prokurorisë”, ka thënë Misetiq. Ai ka shtuar se kjo është thënë edhe në aktgjykimin ndaj Salih Mustafës më 16 dhjetor 2022. “Nuk është detyrë e trupit gjykues apo e mbrojtjes që t’i

mbushim boshllëqet e provave të tyre”, ka thënë Misetiq. Rrjedhimisht, Misetiqi ka thënë se prokuroria ka theksuar se Zyrapit s’ka qenë pjesë e “Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale”, si dhe anëtarët e saj i fshihnin veprimet nga ai. “Kështu që përgjigjja ime e parë është kjo: Ata thonë që nuk ka qenë pjesë e NPK-së së pretenduar dhe se anëtarët e NPK-së përpiqeshin t’i fshinin veprimet prej tij”, ka thënë ai, duke shtuar se Zyrapit ka qenë gjithandej vendeve ku pretendohet se kanë ndodhur krimet, por prokuroria ka thënë se ai nuk ka qenë pjesë e NPK-së.

VEPRIMTARI SHQIPTAR GUBETINI FTON BASHKATDHETARËT NË PROTESTË MË 17 SHKURT NË SHESHIN ‘SKËNDERBEU’

Veprimtari i çështjes kombëtare, Shqiptar Gubetini, i cili jeton në Regensburg të Gjermanisë, u ka bërë thirrje bashkatdhetarëve që të marrin pjesë në marshin e organizuar nga “Liria ka Emër”, më 17 shkurt në sheshin “Skënderbeu”, në Prishtinë, me moton “Drejtësi, jo politikë”, në mbështetje të krerëve të UÇK-së, që po mbahen në Hagë. Në thirrjen e tij publike, Gubetini thekson se ky është një moment i rëndësishëm për kombin shqiptar, pasi ka nisur faza përfundimtare e procesit gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. “Në këtë moment të rëndësishëm për kombin tonë, kur ka nisur faza përfundimtare e procesit gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi,

ndojmë për detyrë morale dhe kombëtare të ngremë zërin tonë fuqishëm në mbrojtje të së vërtetës historike”, ka shkruar ai. Sipas tij, lufta e UÇK-së ishte dhe mbetet një luftë e drejtë dhe çlirimtare për liri, dinjitet dhe shtetësi. Ai shpreh bindjen se e vërteta do të triumfojë dhe se, siç thotë ai, “kjo padrejtësi do të marrë fund me lirin e tyre”. Gubetini u ka bërë thirrje burrave e grave, të rinjë e të moshuarve, që më 17 shkurt të bashkohen në protestë për të dëshmuar unitetin dhe përkushtimin ndaj çështjes kombëtare.

“Le ta tregojmë edhe një herë se mërgata shqiptare është e gjallë, e ndërgjegjshme dhe gjithmonë në krah të së drejtës”, përfundon ai thirrjen e tij, duke e shoqëruar me motot: “Liri për çlirimtarët”, “Drejtësi për UÇK-në” dhe “Dinjtet për Kosovën”.



PA DIALOG, PA BE? SFIDA E MANDATIT KURTI 3

PRISHTINË, 16 SHKURT - Albin Kurti e fitoi besimin e votuesve me një diskurs të fortë për sovranitetin e Kosovës dhe barazinë si shtet. Por, mandatin e ri kryeministri e nis në një kohë kur marrëdhëniet transatlantike janë të brishta dhe sfidat gjeopolitike të reja. Ata që e vëzhgojnë, thonë se është thelbësore për Kurtin që ta rikthejë besimin e aleatëve dhe t'i shmangë hapat surprizë - në të kundërtën, rrezikjet janë serioze.

Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit fitoi bindshëm zgjedhjet e 28 dhjetorit, duke marrë mbi 51 % të votave dhe duke thyer rekordin e saj. Pas muajsh bllokadë politike, për shkak se zgjedhjet e shkurtit 2025 nuk i dhanë të njëjtin sukses, Kurti u rizgjodh kryeministër më 11 shkurt dhe u zotua se mandati i tij i ri do të fokusohet në rezultate konkrete dhe qeverisje efektive për qytetarët. “Mandati të cilin po e kërkojmë është mandat pune, drejtësie dhe dinjiteti për secilin. Mandat sigurie dhe begatie për të gjithë”, tha Kurti natën kur u votua qeveria e tij. Gjatë prezantimit të kabinetit të ri, Kurti bëri një bilanc të mandatit të kaluar, duke theksuar arritjet në ekonomi, siguri dhe demokraci, dhe paraqiti prioritetet e ardhshme në arsim, mirëqenie sociale dhe energji.

Në politikën e jashtme ai nënvizoi se do të punojë me këdo mbi bazën e respektit të ndërsjellë, se aleancat me BE-në, ShBA-në dhe NATO-n mbeten të palëkundura, dhe se normalizimin me Serbinë do ta ndjekë përmes dialogut konstruktiv dhe kreativ.

“Siç kemi vepruar në katër vjetët e kaluar, normalizimi është çështje e rregullimit të marrëdhënieve mes dy shteteve, pra si raport bilateral e i jashtëm e jo ndërhyrje apo përzierje në çështje të brendshme”, tha Kurti. Kurti shërbeu për disa javë kryeministër edhe në vitin 2020, por ajo qeveri u rrëzua pas mospajtimeve mes partnerëve të koalicionit rreth menaxhimit të pandemisë Covid-19.

E mandati i tij i plotë, që pasoi më vonë, u karakterizua thellësisht nga vendosmëria për ta shtrirë autoritetin e institucioneve të Kosovës në veri të vendit - zonë e banuar me shumicë serbe - ku për vite me radhë nuk janë zbatuar vendimet e Prishtinës zyrtare. Pavarësisht prej kundërshtimeve dhe protestave, qeveria e tij arriti t'i zëvendësojë targat serbe të makinave me targa të Kosovës, ta heqë nga përdorimi dinarin serb dhe ta mbyllë shumicën e institucioneve paralele të Serbisë të cilat funksiononin që nga paslufta dhe punësonin mijëra persona.

Këto vendime - thelbësore për vizionin e tij për një Kosovë sovranë - tensionuan ndjeshëm raportet me aleatët. BE-ja dhe



ShBA-ja i cilësuan hapa të pakoordinuar, me pasoja për komunitetin serb. Përplasjet mes tyre u shoqëruan edhe me paralajmërime nga Uashingtoni për përqekësim të partneritetit dhe me masa ndëshkuese ndaj Kosovës - edhe pse, sipas Kurtit, ato ishin thjesht mospajtime mes miqsh.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë tha se shpreson se do të punojë me qeverinë e re për t'i avancuar prioritetet e përbashkëta, përfshirë: paqen rajonale, stabilitetin dhe prosperitetin e ndërsjellë ekonomik, ndërsa shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, tha se është krijuar një momentum i ri për t'i çuar përpara marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës dhe dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Disa vëzhgues vlerësojnë se dialogu me Serbinë duhet të jetë prioritet kryesor i agjendës së jashtme të Kurtit, pasi prej tij varet hapja e Kosovës dhe përparimi i saj drejt integriteteve evropiane.

Abit Hoxha, ligjërues dhe hulumtues në Universitetin Agder në Norvegji, thotë se sovraniteti nuk nënkupton vetëm aftësinë për të ruajtur kufijtë, por edhe aftësinë për të marrë vendime në interesin më të mirë të vendit. Sipas tij, dialogu nuk duhet parë si proces që favorizon Serbinë, por si mjet strategjik për ta forcuar pozicionin ndërkombëtar të Kosovës.

“Implementimi i njëanshëm i marrëveshjeve do ta vendoste Kosovën në një pozitë avantazhi, edhe në raport me BE-në, por edhe me Serbinë. Kosova deri më tash ka ndjekur atë që ka bërë Serbia: moszbatimin e marrëveshjeve”, thotë Hoxha për programin “Expose” të Radios Evropa e Lirë. Dy vendet nuk zhvilluan ndonjë

takim të nivelit të lartë që nga shtatori i vitit 2023. Vazhdimi i dialogut u bllokua pas sulmit në Banjskë, pasi Kurti e lidhi atë me dorëzimin e autorit të dyshuar, Millan Radoiqiq - veprim të cilin Serbia nuk e bëri.

Lulzim Peci, nga Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave, thotë se zbatimi i obligimeve të Kosovës në dialog nuk është për Serbinë, por për të fituar besimin e bashkësisë ndërkombëtare. Vetëm kështu, sipas tij, Kosova mund të hapë rrugën drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës dhe më pas drejt kandidaturës për në BE - çështje për të cilat vendosin vetë vendet e BE-së, e jo Beogradi. “Ne duhet ta dimë se me Serbinë përvoja tregon se mund të arrish marrëveshje dhe të fillosh t'i zbatosh, por nuk duhet pritur prej saj se do t'i zbatojë të gjitha pikat ashtu siç merresh vesh, sepse Serbia e ka stilin negociues të Rusisë në raport me Kosovën. Pra, ti mendon që ke arritur një marrëveshje dhe papritmas e sheh veten në mes të oqeanit”, thotë Peci për “Exposenë”.

Peci nënvizon se, në këtë kontekst, hapat e parë duhet të jenë dërgimi i draftit të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe rregullimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe - çështje që janë të brendshme, por me ndikim të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet ndërkombëtare, sipas tij.

“Kosovës i duhet tani të mos ndërmarrë veprime prapa shpinës së aleatëve, veçanërisht për çështjet e veriut dhe komunitetit serb. Rindërtimi i besimit me Perëndimin do të kërkojë kohë, pasi qëndrimi i tij pas humbjes së besimit në Qeverinë e Kosovës do të testohet në muajt në vijim”, thotë Peci. Raportet transatlantike janë në një pikë të ulët, të tensionuara

nga një varg çështjesh - nga pasiguria mbi mbështetjen për Ukrainën dhe situata në Gazë, tek interesat amerikane për Grenlandën.

Ndaj, Kurt Bassuener, nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Berlin, sugjeron që Kosova t'i menaxhojë me kujdes marrëdhëniet me ShBA-në dhe ta forcojë pozicionin e saj në Evropë, duke synuar njohjen nga pesë vendet që nuk e kanë njohur ende dhe duke u paraqitur si një aset për një BE më të unifikuar dhe të qëndrueshme. “Duhet t'i shohë Kosova interesat e saj afatgjata në funksion të garantimit të pavarësisë së saj dhe aftësisë për të qenë shtet demokratik dhe vetëqeverisës. Dhe tani... do të thosha se kjo është më e mundshme përmes Evropës - edhe pse është e dhimbshme ta pranojmë - sesa përmes Shteteve të Bashkuara nën menaxhimin aktual”, thotë Bassuener për “Exposenë”.

Ai shton se Kosova duhet të jetë e hapur ndaj partnerëve të rinj që mund ta forcojnë pavarësinë dhe sigurinë e saj, por duke ruajtur gjithmonë përputhshmërinë me aspiratat evropiane.

Hoxha, në anën tjetër, insiston që Kosova të jetë më proaktive me ShBA-në, duke iniciuar vetë çështje në interes të saj. “Nuk duhet Kosova të refuzojë qëndrime që vijnë nga Shtëpia e Bardhë në interesin e Kosovës. Ajo duhet të shohë më përtej. Kemi pasur një seri ndërhyrjesh nga Departamenti Amerikan i Shtetit gjatë mandatit të kaluar, të cilat janë refuzuar në mënyrë kategorike dhe kanë shkaktuar përçarje mes dy vendeve”, thotë Hoxha.

E derisa politikanët diskutojnë për strategji dhe marrëdhënie ndërkombëtare, për prioritete e vendime, qytetarët e zakonshëm e ndjekin jetën me shqetësime

krejt të tjera: nga pensionet dhe sigurimet shëndetësore deri te shërbimet e përditshme që ndikojnë në xhepin e tyre. Ata duan që politika e qeverisë së re Kurti të përkthehet në përmirësime konkrete por shpresa, për fat të keq, është më e hollë se dëshira.

“Kemi shumë gjëra që duhen rregulluar, por mendoj se një prej prioritetëve do të duhej të ishte siguri shëndetësor, çështja e pensioneve, të aktivizohet edhe Trepça, t'u jepen mundësi të rinjve të qëndrojnë këtu, e jo ta shohin largimin si rrugëdalje”, thotë Albulena Billalli nga Prishtina.

“Punësimi më së pari, të krijohen më shumë vende pune për kuadro të reja, sepse kemi ngecje në aspektin e punësimit”, thotë Shqipe Klinaku.

Jeremije Aksentijeviq nga Mitrovica e Veriut thotë se qeveria e re duhet të kujdeset më shumë për popullsinë e moshuar, e cila “mezi ia del deri në fund të muajit”. “Ne të gjithë i kemi dokumentet e Kosovës, letërnjoftimet, pasaportat, të gjitha...”, shprehet ai.

Në skenarin më optimist, mandati i qeverisë Kurti 3 zgjat deri në vitin 2030, kur disa vende fqinje mund të jenë anëtarësuar në BE - së paku sipas sinjaleve të Brukselit për Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Kosova mbetet e vetmja në Ballkanin Perëndimor pa status kandidatit për BE, edhe pse Kurti e përshkruan vendin si “më demokratikun në rajon”, me pasaportën “më të fortë se kurrë”.

Për ekspertë si Lulzim Peci kjo nuk mjafton. Ai paralajmëron se pa koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë Kosova rrezikon të mbetet e izoluar - një pasojë e rrezikshme kjo në një skenë ndërkombëtare të paqëndrueshme.

TRUMPI URON KOSOVËN PËR 18-VJETORIN E SHTETËSISË

PRISHTINË, 16 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump e ka uruar Kosovën për 18-vjetorin e shtetësisë së saj dhe e ka rikonfirmuar mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara për sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, ka bërë me dije Presidenca e Kosovës. Në letër e nisur nga Trumpi, Kosova është përgëzuar për pjesëmarrjen në themelimin e Bordit të Paqes si dhe për mbështetjen e këtij vendi në përpjekjet e ShBA-së për t'i zgjidhur problemet globale në Ukrainë, Gazë dhe vende të tjera. "Teksa marrëdhënia mes dy vendeve vazhdon të rritet, ne mirëpresim zgjerimin e partneritetit përmes

bashkëpunimit tregtar dhe investimeve. Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të punojnë së bashku me Kosovën për ta avancuar paqen dhe stabilitetin për të mirën e përbashkët", është thënë në letër. Shtetet e Bashkuara i kanë ndarë mbi dy miliardë dollarë për Kosovën që prej vitit 1998. Udhëheqës shtetërorë të Kosovës e kanë përsëritur ndër vite që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike. Në këtë linjë, Kosova së fundmi i është bashkuar nismës së Trumpit, Bordi i Paqes, përmes së cilës ShBA-ja synon dhënien fund të konflikteve në botë.



Megjithatë, marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe ShBA-së me raste janë tensionuar për shkak të disa veprimeve të qeverisë paraprake të kryeministrit Albin

Kurti që kishin të bënin me minoritetin serb dhe në sytë e zyrtarëve amerikanë ishin të njëanshme dhe të pakoordinuara.

Për pasojë, ShBA-ja vitin e kaluar e ka pezulluar Dialogun Strategjik me Kosovën pa nisur ende. Por, nga Ambasada Amerikane në Prishtinë i kanë thënë 'Radios Evropa e Lirë' në javët e fundit se ShBA-ja është e gatshme ta rinisë këtë proces me Kosovën dhe të punojë me Kurtin, i cili javën e kaluar e ka nisur mandatin e tretë si kryeministër. ShBA-ja ka qenë ndër vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008. Shtetësia e saj njihet nga 121 shtete, por sfida mbetet ende mosnjohja nga katër shtete të NATO-s dhe pesë të Bashkimit Evropian, dy trupa në të cilët Kosova synon të anëtarësohet.

MAQEDONCI I QUAN TË "PAPËRGJEGJSHME" DEKLARATAT E GJENERALIT SERB PËR FSK-në

PRISHTINË, 16 SHKURT - Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, i ka quajtur "të pavërteta dhe të papërgjegjshme" deklaratat e kreut të ushtrisë serbe se shndërrimi në ushtri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) mund të përbëjë kërcënim për komunitetin serb në vend. Kreu i ushtrisë serbe, gjenerali Millan Mojsilović, kishte thënë për gazetën "Politika" se fuqizimi dhe modernizimi i FSK-së kishte "karakter kërcënues" për serbët e Kosovës dhe se "nuk i kontribuon paqes". Në një reagim në "Facebook" të hënën, Maqedonci i hodhi poshtë pretendimet e tij, duke thënë se

FSK-ja është forcë profesionale, e ndërtuar sipas standardeve më të larta demokratike. Vitet e fundit Kosova ka marrë ose blerë pajisje të ndryshme ushtarake kryesisht nga ShBA-ja, si dronët RQ-20 Puma, raketat Javelin dhe automjetet Humvee, në përpjekje për t'u ndërruar në ushtri. "Fuqizimi dhe modernizimi i Ushtrisë së Kosovës nuk ka karakter kërcënues ndaj askujt. Ai përbën një të drejtë legjitime të çdo shteti sovran dhe një domosdoshmëri për garantimin e paqes, stabilitetit dhe sigurisë afatgjatë në vend dhe në rajon", tha Maqedonci.



Maqedonci nguli këmbë se mandati i saj "është dhe mbetet mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe garantimi i sigurisë për të gjithë qytetarët tanë, pa dallim". Ai shtoi se deklaratat e tilla "synojnë frikësimin e

komuniteteve ose justifikimin e politikave destabilizuese nuk kontribuojnë në paqe dhe stabilitet". Serbët përbëjnë rreth 3.31 % të popullsisë në Kosovë sipas regjistrimit zyrtar të vitit 2024. FSK-ja edhe sot duhet të marrë leje nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, për të operuar në pjesën veriore të vendit, ku popullata shumicë është serbe. Ky kufizim u vendos nga ish-presidenti Hashim Thaçi në vitin 2013 përmes një letre të dërguar shefit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, dhe mbetet në fuqi. Ndërkohë, shndërrimi i FSK-së në

ushtri paritet të përfundojë në vitin 2028, sipas planit, thanë për Radion Evropa e Lirë zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes. Tash për tash po zhvillohen kapacitetet ajrore, po forcohen regjimentet luftarake dhe po punohet për ta plotësuar komponentin e rezervës me 3 000 pjesëtarë, pasi objektivi për 5 000 trupa të rregullta është arritur tashmë. Gjithashtu, FSK-ja po përgatitet të bashkohet me Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën, e cila është pjesë e planit për paqe në këtë rajon, të propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump.

REKTORI I UP-SË, ARBEN HAJRULLAHU: KOHA E UZURPIMIT TË PRONAVE TË UP-SË MBAROI, HAPËSIRAT TË LIROHEN MENJËHERË

PRISHTINË, 16 SHKURT - Në një intervistë për RTK-në, rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, tha se UP-ja është shumë më mirë se që ka qenë, derisa deklaroi se po punohet fort që universiteti të jetë në hap me kohën në të cilën po jetojmë. Rektori Hajrullahu para shikuesve paraqiti disa nga rezultatet e arritura gjatë udhëheqjes së tij si dhe vizionin dhe planin e tij për zhvillimin e mëtutjeshëm të UP-së, të bazuar në tri pika: rritjen e ndërveprimit mes njësive akademike, ndërkombëtarizimin dhe transformimin digjital. Ai theksoi se gjatë vitit të kaluar UP-ja si kurrë më parë ka zgjeruar bashkëpunimin me universitete, institucione dhe organizata nga vende të

ndryshme të botës, si dhe me institucione dhe organizata vendore, duke nënshkruar mbi 100 marrëveshje të reja bilaterale, më shumë se 50 në kuadër të programit Erasmus+ të BE-së. Gjatë vitit 2025, mbi 400 studentë, profesorë dhe staf administrativ i UP-së qëndruan jashtë vendit për disa muaj, ndërsa rreth 130 studentë dhe 130 profesorë nga jashtë u mirëpritën në UP. Rektori, po ashtu, paraqiti një plan të transformimit digjital të hartuar nga UNDP-ja, me të cilin synohet që në një periudhë nga 3 deri në 5 vjet ta bëjë universitetin më të qasshëm për publikun dhe t'i depersonalizojë proceset administrative e me këtë edhe t'i zvogëlojë mundësitë e dukurive negative duke rritur transparencën e

llogaridhënien. Drejtuesi i UP-së tha se ka kërkuar e do të kërkojë nga institucionet e vendit dhe donatorët mbështetje financiare për këtë e për projekte të tjera. Rektori Hajrullahu tha se është shumë e nevojshme edhe një pako sociale për UP-në me të cilën disa nga punonjësit do të mund të dilnin në pension të parakohshëm, derisa paralajmëroi që në të ardhmen pagat dhe lartësia e tyre do të duhej të ishin në përputhje me angazhimet dhe performancën e personelit. Ai tregoi edhe një herë pikëpamjen e tij për thelbin e misionit dhe qëllimit të një institucioni të arsimit të lartë. Shpjegoi se një universitet duhet të përgatisë njerëz që mendojnë në mënyrë racionale e kritike dhe që ata të pajisen me aftësi



për të qenë të suksesshëm në profesion e jetë. Rektori Hajrullahu tregoi se kurrë më mirë nuk kanë qenë as raportet e menaxhmentit me studentët dhe i porosi studentët që të jenë edhe më ambiciozë e më kërkues. Rektori Hajrullahu njoftoi se në shumë raste pronat e UP-së janë

nën sulm, të uzurpuara ilegalisht. Ai njoftoi që UP-ja po punon që pronat e uzurpuara ilegalisht të lirohen duke i ballafaquar uzurpatorët me ligjin, si dhe u bëri thirrje publike organeve të rendit që sulmuesit, uzurpatorët ilegalë të pronave të UP-së, pa humbur kohë e në mënyrë proaktive t'i ballafaqojë me forcën e shtetit ligjor. Kështu, rektori Hajrullahu i porosi të gjithë uzurpatorët, shfrytëzuesit ilegalë të pronave të UP-së, që pa humbur kohë t'i palosin çantat dhe të largohen nga të gjitha pronat e uzurpuara ilegalisht, pa përjashtim. Pronat që duhen liruar me urgjencë dhe vënë sa më parë në shfrytëzim të UP-së janë edhe pronat e uzurpuara tek objekti i ri i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë.

PROJEKTLIGJI PËR BUXHETIN MIRATOHET NË LEXIM TË PARË

PRISHTINË, 16 SHKURT - Me 66 vota për, 32 kundër dhe pesë abstenime, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2026. “Falënderoj deputetët e Kuvendit për votimin e buxhetit”, ka thënë kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu. Arbërie Nagavci, shefe e grupit parlamentar e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ka propozuar që shqyrtimi i dytë i projektligjit për buxhetin të bëhet më 20 shkurt në orën 11:00. Ky propozim është miratuar me 67 vota të deputetëve. Kryetarja Haxhiu ka kërkuar nga komisionet funksionale për buxhet, si dhe nga komisionet e tjera parlamentare, sipas fushave që mbulojnë, që ta shqyrtojnë projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2026 si dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandimet.

Opozita kritikon prezantimin e buxhetit 2026, Kurti: Ka rritje në të gjithë sektorët

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ata të opozitës i kanë thënë zëshëm dallimet në

qëndrime lidhur me Projektligjin për Buxhetin, të dorëzuar në Kuvend nga Qeveria e re e Kosovës. Opozita ka bërë me dije se duhen ndryshime në këtë buxhet, madje ky buxhet para tyre është paraqitur i njëjti me atë të tetorit të kaluar. Në fjalën e tij, kryeministri Albin Kurti ka thënë se fillimisht u dashtë të paraqitej programi qeveritar, më pas buxheti. “Më 31 tetor të vitit 2025 ne e patëm miratuar buxhetin për vitin 2026 por, siç e dimë, legjislatura e nëntë përfundoi ashtu siç përfundoi, mirëpo tani kemi legjislaturën e dhjetë dhe nuk mund të quhet i njëjtë projektbuxheti i këtij viti. Nuk do të ishte normale që ne ta sjellim buxhetin, para se ta bënim ekspozenë, andaj në këtë buxhet që kemi paraqitur te ju kryefjala është shifra prej katër miliardë eurosh”, ka thënë Kurti, duke shtuar se risi e këtij buxheti është paga e 13. “Andaj kjo nuk do të jetë në fund të vitit, por në pranverë. Po ashtu edhe ligji për 15 vitet e para të përvojës së punës, andaj kemi dyfishim të pagës mbi përvojën e punës. Buxheti për vitin 2026 përfshinë edhe shtesat për fëmijë, për gratë lehona, për pensionistët dhe shumë e shumë rritje të tjera”,



potençoi më tej ai. Kurti shtoi se ky buxhet u paraqit si një status-quo, por që ky buxhet ka një rritje në të gjithë sektorët. Ndërsa kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, tha se vendi ka nevojë për buxhet, por kritikon urgjencën për miratimin e tij. “E kuptoj rëndësinë që vendi të ketë buxhet, mirëpo nuk e kuptoj pse kjo urgjencë kaq e madhe. Nuk dua të besoj se kjo lidhet me zgjedhjen e presidentit. E para, t’u pamundësojmë deputetëve të shprehin kritika për këtë dokument të rëndësishëm. E dyta, vendi ka nevojë për institucione”, tha Hamza. Lumir Abdixhiku, kryetar i LDK-së, kërkoi që buxheti t’i reflektojë

ndryshimet në strukturën e qeverisë dhe zotimet e ekspozesë së kryeministrit. “Buxheti duhet ta reflektojë strukturën e ministrive, të mos ndahet vetëm nga Ministria e Financave, por nga Kuvendi. Po ashtu, duhet ta pasqyrojë ekspozenë që Kurti paraqiti në ditën e formimit të qeverisë dhe ta sigurojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë”, tha Abdixhiku. Ndërsa Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kritikoi faktin që buxheti nuk reflekton premtimet qeveritare dhe projekti i miratuar është i njëjti me atë të 31 tetorit 2025.

“Esenca është se ky buxhet është miratuar më 31 tetor 2025 dhe në tabelat e projekteve kapitale është i njëjti. Ky është një buxhet provizor, që për pak muaj do t’i nënshtrohet rishikimit dhe nuk reflekton premtimet e qeverisë”, tha Tahiri. Ministri i Financave, Hekuran Murati, gjatë arsytimit të Projektligjit para deputetëve tha se qeveria ka propozuar që projektligji të procedohet në formën aktuale pa reflektuar strukturën e re të qeverisë, por se rishikimi do të bëhet brenda muajit. Ai theksoi se ligji parashikon ndryshime në tabelat e buxhetit. Murati bëri me dije se të hyrat buxhetore për vitin 2026 janë 3.64 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve do të mbulohet me kredi apo deficit. “Buxheti i vitit 2026 ka kufirin e shpenzimit rreth 4 miliardë euro, të cilat ndahen në paga dhe shtesa 980 milionë euro, mallra dhe shërbime 545 milionë euro, subvencione dhe transfere 1 miliard e 358 milionë euro, shpenzime kapitale 998.4 milionë euro dhe 100 milionë euro të tjera nga klauzola e investimeve. Deficiti mbulohet përmes huamarrjes ose granteve”, tha Murati.

AKB-ja: FUQIA E 10 BIZNESEVE NË KOSOVË, RRETH 2.5 MILIARDË EURO QARKULLIM, 25 MIJË VENDE PUNE DHE 23 % E BPV-së

PRISHTINË, 16 SHKURT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka vlerësuar lart performancën e kompanive më të mëdha që operojnë në Kosovë gjatë vitit 2025 të cilat dëshmojnë qartë fuqinë reale të sektorit privat dhe rolin e tij vendimtar në zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social të vendit. Sipas analizës së AKB-së, vetëm këto 10 kompani realizojnë rreth 2.5 miliardë euro qarkullim vjetor, që përfaqëson afërsisht 22 – 23 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto të Kosovës. Ato janë ndër taksapaguesit më të mëdhenj në vend dhe punësojnë rreth 25 mijë punëtorë, duke qenë shtylla kryesore e ekonomisë, punësimi



dhe mirëqenies sociale. Sipas të dhënave, kompania energjetike “Kosovo Calik Limak Energy” kryeson listën me një qarkullim

prej 437 milionë eurosh. Në mesin e kompanive lidere renditen edhe “VivaFresh Store” me 393 milionë euro, “ELKOS” me 247 milionë,

“HIB Petrol” me kompanitë e ndërlidhura me 236 milionë, “Proex (Intrex)” me 235 milionë, “Ex FIS” me 220 milionë, “KEK-u” me 200 milionë, “Noa Energy Trade” me 185 milionë, “Buçaj” me 175 milionë, si dhe në top-10 “AlbaPetrol Group” me 162 milionë euro qarkullim. “Statistikat tregojnë qartë se gjatë vitit 2025 sektorët e energjisë, derivateve dhe tregtisë me pakicë kanë qenë motorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe stabilitetit financiar të vendit. Mesazhi është i qartë: pa biznese të forta nuk ka ekonomi të fortë, ndërsa pa dialog dhe politika të qëndrueshme nuk ka zhvillim afatgjatë. Aleanca

Kosovare e Bizneseve vlerëson se këto kompani duhet të trajtohen si partnere strategjike të institucioneve përmes politikave të parashikueshme, klimës së favorshme për investime dhe mbështetjes reale për sektorin privat”, thuhet në njoftimin për medie të AKB-së. Në fund, Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve, përgëzon të gjitha kompanitë për këto arritje dhe rithekson se AKB-ja do të vazhdojë të jetë zëri i fuqishëm i bizneseve dhe kontribuues aktiv në ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkurruese dhe të qëndrueshme për Kosovën.

BQK-ja dhe Banka e Shqipërisë hapin ekspozitën “Paraja rrëfen: 100 vjet jetë dhe ngjarje”

PRISHTINË, 16 SHKURT - Me rastin e 100-vjetorit të lekut në qarkullim monetar, Banka Qendrore e Kosovës në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë kanë hapur në hollin e BQK-së ekspozitën me titull “Paraja rrëfen: 100 vjet jetë dhe ngjarje”. I pranishëm në ceremoninë hapëse të kësaj ekspozite ishte edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me ç’rast tha se ekspozita reflekton lidhjen ndërmjet historisë dhe besimit në institucionet e vendit si dhe

bashkëpunimin me Shqipërinë. Ekspozita ndihmon publikun ta kuptojë rëndësinë e stabilitetit financiar dhe besimit në sistemin bankar, tha guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili. Sipas tij, ekspozita e hapur sot dëshmon se historia, ekonomia dhe kultura janë të pandashme. E guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, theksoi rëndësinë historike dhe kulturore të ekspozitës. “Kjo

ndalesë në Kosovë ka një kuptim të veçantë. Historia jonë e përbashkët është e shkruar me sakrifica, përpjekje dhe vizion. Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe figura si Ymer Prizreni, Sylejman Vokshi, Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri dhe shumë të tjerë i kanë dhënë formë legendës kombëtare dhe shtetit shqiptar në kohëra. Dhe po aq e natyrshme është që një ekspozitë që flet për paranë, për BQK-në dhe për rrugëtimin e shtetit shqiptar ta



vizitojë Kosovën, sepse historia që paraja shpalos është e jona,

është histori e shqiptarëve kudo që jetojnë”, ka thënë ai.

FUNDI VARËSISË NGA ENERGJIA RUSE: EUROPA NDRYSHON HARTËN E GAZIT

Katër vjet pas pushtimit të Ukrainës, Europa po ndalon importet e gazit rus. Diversifikimi ka nisur, por pavarësia energjetike mbetet e largët.

Pse Europa po heq dorë nga gazi rus

Katër vjet pas pushtimit të Ukrainës, Europa është gati për shkëputjen përfundimtare nga gazi rus. Vendimi për t'i thënë gradualisht lamtumirë furnizimeve energjetike nga Moska nuk është i ri: ai u bë i qartë që në javët pas natës mes 23 dhe 24 shkurtit 2022 dhe u materializua në planin strategjik RePowerEU. Megjithatë, zbatimi praktik rezultoi shumë më i vështirë sesa deklaratat politike. Për dekada, infrastruktura energjetike europiane ishte ndërtuar mbi një marrëdhënie të fortë me Rusinë, e cila furnizonte rreth 45% të metanit të kontinentit, dhe me çmime konkurruese. Për më tepër, jo të gjitha vendet e BE kishin të njëjtin nivel varësie energjetike, as të njëjtin vullnet politik për një shkëputje kaq të dhimbshme.

Si u rrit çmimi i energjisë pas vitit 2022

Frika nga lufta krijoi një pasiguri të paprecedentë në tregjet energjetike. Kulmi u arrit në verën e vitit 2022, kur Rusia përdori rrjedhat e gazit si instrument presioni gjeopolitik. Në tregun TTF të Amsterdimit, çmimet e gazit arritën nivele historike, duke kaluar 340 euro për megavat-orë. Ky moment shënoi një kthesë strategjike për Bashkimin Europian: infrastruktura energjetike duhej rishikuar dhe burimet e furnizimit duhej të diversifikoheshin urgjentisht.

Strategjia e BE për diversifikimin energjetik

Europa filloi të kërkonte furnizues alternativë dhe të ndërtonte rrugë të reja energjetike.

Roli i Norvegjisë dhe Algjerisë

Norvegjia rriti prodhimin dhe kapacitetin e transportit drejt BE-së, duke u bërë furnizuesi kryesor i gazit përmes tubacioneve. Në jug, Algjeria rriti eksportet, ndërsa gazsjellësi TAP siguroi rrjedhat nga Azerbajxhani.

LNG dhe transformimi i tregut global

Kthesa më e madhe erdhi me zgjerimin e përdorimit të gazit



natyror të lëngshëm (LNG). Për vite me radhë kjo teknologji nuk kishte qenë ekonomisht konkurruese, por kriza energjetike ndryshoi gjithçka.

SHBA dhe Katari si furnizues kryesorë

Shtetet e Bashkuara, falë prodhimit masiv përmes fracking-ut dhe investimeve në lëngëzim, u shndërruan në eksportuesin më të madh të LNG në botë. Edhe Katari rriti furnizimet, duke përforcuar diversifikimin europian.

Shifrat reale të rënies së importeve ruse

Importet e gazit rus ranë nga mbi 150 miliardë metra kub në vitin 2021 në më pak se 52 miliardë në vitin 2024, vetëm

13% e furnizimit total. Në vitin 2025, importet e LNG në BE dhe Mbretërinë e Bashkuar arritën rekord historik prej 162 miliardë metrash kub, kryesisht nga SHBA dhe Afrika. Qymyri rus tashmë është i ndaluar, ndërsa importet e naftës kanë rënë nën 3%, me objektiv eliminimin total deri në vitin 2027. Ndalimi i gazit do të zbatohet gradualisht, duke filluar me kontratat afatshkurtra dhe më pas ato afatgjata. Italia është ndër vendet më të përparuara në tranzicionin energjetik. Duke shfrytëzuar vijën e gjatë bregdetare, ajo ka ndërtuar terminale rigazifikimi dhe sot LNG është burimi kryesor i furnizimit me gaz. Me terminalin e ri në Ravenë, vendi ka pesë pika hyrëse për gazin e lëngshëm. Që nga

fillimi i vitit kanë mbërritur dhjetëra ngarkesa, gjysma nga Shtetet e Bashkuara. Rrjeti italian transporton mbi 60 miliardë metra kub gaz në vit dhe monitorohet vazhdimisht nga qendra e shpërndarjes së Snam pranë Milanos, një infrastrukturë kritike që funksionon pa ndërprerje.


A po krijon Europa një varësi të re energjetike?

Një pjesë e madhe e kërkesës për gaz në Itali dhe në Europë lidhet ende me prodhimin e energjisë elektrike, për shkak të ndërprerjeve të burimeve të rinovueshme. Në janar 2026, kërkesa për metan u rrit ndjeshëm, ndërsa depozitat e magazinimit mbuluan një të tretën e konsumit. Megjithatë,

temperaturat e ulëta dhe prodhimi i dobët nga burimet e rinovueshme zbrazën rezervat më shpejt se zakonisht. Italia zotëron një të gjashtën e kapacitetit total të magazinimit të BE-së dhe ruan nivele mbushjeje mbi mesataren europiane.

E ardhmja e sigurisë energjetike europiane

Rritja globale e ofertës së LNG pritet të sjellë njëfarë lehtësimi në treg. Por ekonomistët paralajmërojnë për një rrezik të ri: varësia e tepërt nga një furnizues i vetëm, këtë herë Shtetet e Bashkuara. Europa po largohet nga varësia energjetike ndaj Rusisë, por sfida e vërtetë është të mos zëvendësojë një varësi me një tjetër. / [bota.al](#)



Muriqi, më i miri në Evropë për gola me kokë

Ylli i Kosovës, Vedat Muriqi, po vazhdon të shkëlqejë këtë edicion të Mallorca. Pas supergolit ndaj Real Betisit, Muriqi është bërë golashënuesi më i mirë në Evropë për gola me kokë, plot gjashtë sosh. Përpos kësaj, ai ka barazuar

rekordin e legjendës së Mallorcas, Pierre Webo, për më së shumti gola me kokë në një sezon, rekord që s'ishte prekur që nga sezoni 2010/11. "Vedat Muriqi është golashënuesi më i mirë me kokë në top pesë ligat

evropiane këtë edicion dhe është bërë lojtari i parë i Mallorcas që shënon gjashtë gola me kokë në një sezon të vetëm që prej Pierre Webo në sezonin 2010/11", raporton "OptaJose". Muriqi po kalon sezonin më të

mirë të karrierës, për të qenë golashënuesi i dytë më i mirë në La Liga me 16 gola, shtatë më pak se ylli i Real Madridit, Kylian Mbappe. Në anën tjetër Mallorca po vuan për rezultate pasi renditet në pozitën e 18 me 24 pikë.



ARMAND DUKA RIZGJEDHET PRESIDENT I FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

TIRANË, 16 SHKURT - Asambleja e Përgjithshme Zgjedhore e Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF) ka rikonfirmuar të hënën besimin e plotë ndaj Armand Dukës, duke e rizgjedhur president edhe për një mandat të ri katërvjeçar. Vendimi është marrë me votë unanime nga të gjithë anëtarët me të drejtë vote, një shprehje e qartë e mbështetjes dhe unitetit brenda komunitetit të futbollit shqiptar. Procesi është zhvilluar në ambientet e "Shtëpisë së Futbollit" ku delegatët kanë vlerësuar lidhshimin, vizionin dhe kontributin e presidentit

Duka në zhvillimin e futbollit në vend si në aspektin sportiv, po ashtu edhe në atë organizativ dhe institucional. Ky mandat i ri jo vetëm ka konfirmuar lidhshimin e presidentit Duka, por edhe angazhimin e FShF-së për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm, promovim të talenteve të rinj dhe rritje të standardeve të futbollit shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Pas rizgjedhjes presidenti i FShF-së, Duka ka falënderuar anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore për besimin e dhënë. Ai është zotuar se do të angazhohet fortë për zhvillimin



e futbollit shqiptar. "Dua t'ju falënderoj edhe njëherë nga zemra për mbështetjen e sotme,

për mbështetjen e vazhdueshme që më keni dhënë mua dhe Federatës Shqiptare të Futbollit.

Për mua ky nuk është thjesht një votim, është një përgjegjësi e madhe, vlerësim dhe më bën, apo më detyron të jem akoma më i përkushtuar në shërbim tuaj dhe të FShF-së. Ju premtoj që ne do të bëjmë maksimumin që federata jonë, loja dhe futbollit ynë, kampionati, ekipet tona kombëtare, zhvillimi i infrastrukturës dhe stabiliteti financiar i FShF-së të jenë në nivelet maksimale në vitet e ardhshme. Uroj që të gjithë ne bashkë të jemi pjesë e Kampionatit Botëror 2026. Suksese Silvinjos dhe ekipit kombëtar. Faleminderit të gjithëve!", ka thënë Duka.

ADEMI URON DUKËN: RIKONFIRMOJ PËRKUSHTIMIN TONË PËR BASHKËPUNIM TË NGUSHTË DHE VËLLAZËROR



Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar Armand Dukën për rizgjedhjen në krye të futbollit të Shqipërisë. Me këtë rast, Ademi ka rikonfirmuar përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë dhe vëllazëror, me synimin e përbashkët për ta çuar futbollin në nivel edhe më të lartë. "E përgëzoj mikun tim Armand Duka për rizgjedhjen në krye të FShF-së. Ky është një vlerësim i qartë për punën,

vazhdimësinë e sukseseve dhe projektet që kanë sjellë zhvillim të qëndrueshëm ndër vite në futbollin shqiptar. Angazhimi i tij edhe në strukturën qeverisëse të UEFA-s si zëvendëspresident është dëshmi e respektit që tashmë gëzon futbollit shqiptar në arenën evropiane. Si president i Federatës së Futbollit të Kosovës, rikonfirmoj përkushtimin tonë për bashkëpunim të ngushtë dhe

vëllazëror, me synimin e përbashkët për ta çuar futbollin në nivel edhe më të lartë. Me besimin se rrugëtimi ynë do të na çojë drejt sukseseve të reja dhe me shpresën që ekipet tona kombëtare ta realizojnë ëndrrën e pjesëmarrjes në Kupën e Botës 2026, i uroj presidentit Duka dhe Komitetit të ri Ekzekutiv të FShF-së shumë suksese në mandatin e ri", është thënë në urimin e Ademit.


Lodzi huazon Gallapenin te Wisla

LODZ, 16 SHKURT - Mbrojtësi i Kombëtares së Kosovës, Dion Gallapeni, do të largohet nga Widzed Lodzi, por jo edhe nga kampionati i Polonisë. Mbrojtësi i krahut të majtë, do ta vazhdojë karrierën te skuadra tjetër polake Wisla Plock, tek ecila do të huazohet pasi tashmë gjithçka është finalizuar mes

palëve. Wisla Plock do ta huazojë Gallapenin deri në fund të sezonit, ku edhe do ta ketë opsionin e blerjes së tij për 700 mijë euro. Nëse futbollisti i Kosovës bind me paraqitje dhe Wisla Plock e bën transferim të përhershëm, atëherë Gallapeni do të jetë

transferimi më i shtrenjtë në historinë e këtij klubi. Në stinorin pranveror Gallapeni nuk ka luajtur asnjë minutë për Widzed Lodzin, duke u huazuar te Wisla Plock, ekip që po lufton për titullin e kampionit të Polonisë. Gallapeni është transferuar te Lodzi në korrik të vitit të shkuar dhe deri më tani

ka 10 paraqitje në Ekstraklasa të Polonisë, ku ka shënuar edhe një gol. Ai ka kontratë deri në vitin 2029 me Lodzin, ekip që pagoi 300 mijë euro për ta transferuar nga skuadra e Prishtinës. 21-vjeçari, gjithashtu, ka edhe tri paraqitje me Kombëtaren e Kosovës, me të cilën debutoi në muajin mars të vitit të shkuar.





16.02.2026 558/26

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 558/26 të datës 16.02.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 16.02.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 7

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 434.78 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga epriori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të epriorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së epriorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

